UDHËZIM
Nr. 1, datë 31.12.2012

PËR VËRTETIMIN E KOPJES NË LETËR TË DOKUMENTIT ELEKTRONIK NGA INSTITUCIONET PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 102 paragrafi 4 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të paragrafit 1 të nenit 10 dhe të pikës 1 të nenit 21 të ligjit nr. 10 273/2010 "Për dokumentin elektronik", Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit

UDHËZON:

1. Autoriteti kompetent për lëshimin e kopjes në letër të dokumentit elektronik është institucioni, i cili krijon dokumentin elektronik, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10 273/2010 "Për dokumentin elektronik".

2. Kopja në letër e dokumentit elektronik është forma e jashtme e paraqitjes së tij.

3. Titullari i institucionit publik autorizon personin që vërteton kopjen në letër të dokumentit elektronik.

4. Kopja në letër e dokumentit elektronik ka të njëjtën vlerë ligjore me dokumentin elektronik kur realizohet në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 10 273/2010 "Për dokumentin elektronik" dhe këtë udhëzim.

5. Kopja në letër e vërtetuar si kopje e dokumentit elektronik duhet të përmbajë elementet e mëposhtme:

a) shënimin "Kopje e njëjtë me dokumentin elektronik". Ky shënim duhet të jetë në çdo faqe të kopjes në letër në një vend të dukshëm e të qartë;

b) çdo faqe e kopjes në letër të dokumentit elektronik nënshkruhet nga personi i autorizuar prej titullarit të institucionit;

c) kopja në letër e dokumentit elektronik shoqërohet me një shkresë, sipas aneksit 1 (bashkëlidhur). Kjo shkresë ngjitet në mënyrë të sigurt me kopjen në letër të dokumentit elektronik;

d) mungesa e elementeve të mësipërme cenon barasvlershmërinë ligjore të kopjes në letër të dokumentit elektronik.

6. Tarifa dhe vlera përkatëse për shërbimet që lidhen me vërtetimin e kopjes në letër të dokumentit elektronik përcaktohet nga titullari i institucionit që lëshon dokumentin.

7. Kopja në letër e dokumentit elektronik trajtohet në përputhje me kërkesat e ligjit për arkivat dhe me normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pasi botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI PËR INOVACIONIN DHE TEKNOLOGJINË
E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT
Genc Pollo

Aneksi 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
EMËRTIMI I INSTITUCIONIT

Adresa:
Nr. _____Prot. Dita.muaj.viti

Lënda: Vërtetim i kopjes në letër të dokumentit elektronik

Vendndodhja

VËRTETIM

Bazuar në pikën 1 të nenit 10 të ligjit nr. 10 273, datë 29.4.2010 "Për dokumentin elektronik" dhe udhëzimit nr. _____, datë____.____2012 të Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, me autorizimin nr. ____, datë_____, lëshuar nga z/znj._____ (titullari i institucionit)_____, vërtetoj se kjo kopje në letër është:

"Kopje e njëjtë me dokumentin elektronik"

Titulli/përshkrimi i dokumentit bashkëlidhur:_____
Numri i faqeve të dokumentit bashkëlidhur:_____(me numra dhe shkronja)
I autorizuar:

(Emërtimi i detyrës)
(Emri/mbiemri)
(Nënshkrimi i personit të autorizuar)
(Vula e institucionit)